



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-032, UA Nr.10/2018, UA 151/2020, nenit 4.5 dhe 6 paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L212, neni 80 i ligjit për zyrtarët publik nr. 08/L-197 , UA nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, UA Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, lidhur me kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës ,Komuna e Fushë Kosovës me datë **29.07.2024** shpallë :

K O N K U R S

Për themelimin e marrëdhënies së punës me afat të caktuar

1.Titulli i vendit të punës : Zyrtar Publik

Titulli i punës : Drejtor i SHFMU

Orari i plotë i punës : 40 h në javë

Vendi i punës : Shfmu “Lismiri “ Fushë Kosovë

Raporton tek : Drejtori i DKA-së.

Mandati : 4 vjeçar

Pozita të lira : 1

Koeficienti : E14 – 6.2

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR PRANIMIN E ZYRTARIT TË SHËRBIMIT PUBLIK:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

- Formulari i konkurrimit të jetë i plotësuar;
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letëmjoftimi) kopje;
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata e shtetësisë;
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Certifikata e diplomimit e noterizuar (të mos jetë më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit);
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosove duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHTI;
- Certifikata që nuk është nën hetime.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SHFMU :

1. Drejtori/ esha ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit ,duke përfshirë :

1.1 Përgatitjen e planit vjetor ,planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës ;

1.2 Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi ,procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit ;

1.3 Detyrat e caktuara për zgjedhjen e edukatoreve, vlerësimin ,disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me edukatorët dhe punëtorët tjerë të institucionit;

1.4 Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të plan programit ;

1.5 Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor , si dhe mekanizmave tjerë të institucionit edukativ që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;

1.6 Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KD),Këshillin e Prindërve dhe komunitetin e institucionit edukativ ;

1.7 Raporton së paku dy herë në vit para KD;

1.8 Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët në institucionin edukativo-arsimor.

1.9 Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave ,siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);

1.10 Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim para universitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

2. Kushtet e konkurrimit:

-Kandidatet e interesuar për të konkurruar për pozitat për drejtor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

-Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës ;

-Të kenë të kryer arsimin universitar. Nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi.

-Master për udhëheqje ,administrim ose menaxhim në arsim(kualifikimin prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);

-Master arsimor(kualifikimin prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);

- Katërvjeçar kualifikimin prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar);

-Bachelor katërvjeçar kualifikimin prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar);

-Të kenë licence të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit.

-Të kenë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për Udhëheqje ,Administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;

- Të kenë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës 4 vite përvojë pune për drejtor.

Kandidatët konkurrues duhet të posedojnë këto dokumente:

1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;

2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje ,administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;

3. Kandidati ose kandidatja që ka përfunduar programin universitar Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje arsimore ,ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;

4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID)

5. Certifikatën shëndetësorë të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij, e saj shëndetësore;

6. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;

7. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;

8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati, kandidatja nuk ka

qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.

9. Portofolin profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën e formularit H, të UA 151/2020 nga MASH. (PLANIN E PUNES).

KRITERET E VLERËSIMIT:

Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë, ndërsa intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

AFATI I APLIKIMIT:

Data e njoftimit të konkursit 29.07.2024

Afati për pranimin e aplikacioneve është tridhjetë(30) ditë kalendarike nga data 29.07.2024

MËNYRA E APLIKIMIT

Formulari i aplikimit për punësim merret në zyrën pritëse në Objektin e Komunës së Fushë Kosovës, rruga “Tahir Zemaj” nr. 2 12000 nga ora 08:00 – 16:00, si dhe mund të shkarkohen nga ueb faqja SIMBNJ – *konkursi.rks-gov.net*.

MËNYRA E DORËZIMIT

Aplikacioni i nënshkruar së bashku me dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrën pritëse në objektin e Komunës.

Rezultatet shpallen në ëeb-faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në intervistë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

